



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

U R D H Ë R

Nr. 18, datë 22.1.2014

PËR

**KRIJIMIN E KOMITETIT NDËRMINISTROR TË PLANIFIKIMIT
STRATEGJIK**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 11, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

U R D H Ë R O J:

1. Krijimin e Komitetit Ndërmintor të Planifikimit Strategjik për përcaktimin e strategjisë parësore të planifikimit të integruar dhe jetësimin të prioriteteve.
2. Komiteti Ndërmintor i Planifikimit Strategjik të kryesohet nga Kryeministri dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - Zëvendëskryeministrin;
 - Ministrin e Financave;
 - Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
 - Ministrin e Integritimit Evropian;
 - Ministrin/at e përcaktuar në rendin e ditës së mbledhjes përkatëse të komitetit.
3. Komiteti Ndërmintor i Planifikimit Strategjik ka për detyrë:
 - të miratojë drejtimet themelore të strategjisë së zhvillimit të vendit, strategjitë kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale;

- të përcaktojë dhe të miratojë përparësitë e Këshillit të Ministrave;
 - të përcaktojë dhe të miratojë kornizën e planifikimit të buxhetit afatmesëm (kalendarin, vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike, tavanet e përgatitjes dhe të shpenzimeve të PBA-së si dhe PBA-në);
 - të bëjë përcaktimin strategjik të taveve buxhetore, të programeve dhe projekteve kryesore të investimeve publike në funksion të përparësive të qeverisë;
 - të realizojë bashkërendimin strategjik të ndihmës së huaj me komunitetin e donatorëve, të miratojë shpërndarjen e saj në programet dhe projektet sipas përparësive të qeverisë;
 - të vlerësojë dhe të monitorojë ecurinë e zbatimit të prioritetëve, programeve, investimeve kryesore dhe riprogramimin e tyre.
4. Në mbledhjet e Komitetit Ndërmnistror të Planifikimit Strategjik ftohen të marrin pjesë, sipas rastit, specialistë të çështjeve që do të shqyrtojnë ky komitet.
5. Komiteti mbledhet si rregull një herë në muaj, me kërkesë të kryetarit ose të zëvendësuesit të tij.
6. Si pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj të ngrihet sekretariati teknik i Komitetit Ndërmnistror të Planifikimit Strategjik, i cili të organizojë dhe të përgatitë propozimet për shqyrtim dhe miratim dhe dokumentacionin e mbledhjes së komitetit, të komunikojë me institucionet dhe t'i përcjellë porositë e tij, si dhe të kryejë çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga komiteti, në përmbushje të përgjegjësive të veta.
7. Urdhri nr.14, datë 30.1.2006, i Kryeministrit "Për krijimin e Komitetit Ndërmnistror të Planifikimit Strategjik", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

